



## TERMAT E REFERENCËS (ToR)

### Shërbime konsulente për hartimin dhe themelimin e një kornize për Monitorim dhe Vlerësim (M&V) për Arsim Dual

#### 1. Informata të përgjithshme

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) është organizata kryesore e anëtarësimit të bizneseve që përfaqëson sektorin privat në Kosovë. OEK ka kaluar nga një partner mbështetës në një aktor kryesor të sistemit në promovimin dhe mbështetjen e zbatimit të Arsimit Dual në Kosovë. Që nga viti i kaluar, OEK ka qenë shumë aktive në ndërtimin e një ure lidhëse ndërmjet shkollave profesionale dhe sektorit privat.

Në gusht të vitit 2025 është themeluar Qendra për Arsim Dual (QAD). Kjo e fundit shërben si një qendër e dedikuar brenda OEK-ut për koordinimin e aktiviteteve për promovimin dhe mbështetjen e arsimit dual në Kosovë. Qendra menaxhon stafin e brendshëm dhe konsulentët e jashtëm, duke siguruar përmbushjen e nevojave të sektorit privat dhe të fuqisë punëtore të kualifikuar, në përputhje me metodologjitë e të mësuarit në vendin e punës dhe sistemin e arsimit dual.

OEK, përmes QAD-së, po zbaton aktivitete me qëllim të forcimit të sistemit të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional Dual (VET Dual) në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), shkollat profesionale dhe ndërmarrjet e sektorit privat.

Si pjesë e përpjekjeve për forcim institucional dhe sigurim të cilësisë, OEK synon të krijojë një kuadër gjithëpërfshirës për Monitorim dhe Vlerësim (M&E) për të mbështetur zbatimin e bazuar në evidencë, monitorimin, raportimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të Arsimit Dual në të gjithë Kosovën.

Ky angazhim do të mbështesë zhvillimin e indikatorëve të standardizuar, metodologjive për mbledhjen e të dhënave, strukturave të raportimit, përgjegjësiwe institucionale dhe mjeteve analitike për të mundësuar monitorim efektiv të zbatimit dhe rezultateve të Arsimit Dual.

#### 2. Objektivi i angazhimit

Objektivi i përgjithshëm i kësaj konsulence është hartimi dhe operacionalizimi i një sistemi për Monitorim dhe Vlerësim (M&V) për programin e Arsimit Dual të zbatuar nga OEK.

Angazhimi synon të:

- krijojë një kornizë funksionale M&V;
- zhvillojë mjete të standardizuara për monitorim dhe raportim;
- forcojë kapacitetet institucionale brenda OEK-së për zbatimin e M&V;
- mbështesë vendimmarrjen e bazuar në evidencë përmes analizës së të dhënave dhe raportimit.



### 3. Fushëveprimi i punës

Konsulenti/kompania e përzgjedhur do të realizojë detyrat në vijim:

Nr.	Detyrat	Rezultatet
<b>Detyra 1: Hartimi dhe themelimi i kornizës M&amp;V:</b>		
Nëndetyra	<ul style="list-style-type: none"> <li>të kryejë një vlerësim të shpejtë të praktikave ekzistuese të monitorimit dhe raportimit brenda OEK-ut;</li> <li>të zhvillojë një kornizë gjithëpërfshirës të M&amp;V për aktivitetet e Arsimit Dual;</li> <li>të përcaktojë treguesit, nivelet bazë, objektivat dhe mjetet e verifikimit;</li> <li>të përcaktojë metodologjitë për mbledhjen, validimin, analizën dhe raportimin e të dhënave;</li> <li>të krijojë struktura raportimi dhe rrjedha të të dhënave;</li> <li>të sigurojë përputhshmërinë me objektivat institucionale të OEK-ut dhe kërkesat e raportimit të donatorëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dokumenti i kornizës M&amp;V;</li> <li>Matrica e indikatorëve;</li> <li>Struktura e raportimit dhe rrjedha e punës;</li> <li>Rrjedha e të dhënave dhe metodologjia e verifikimit..</li> </ul>
<b>Detyra 2: Zhvillimi i mjeteve të standardizuara të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave</b>		
Nëndetyra	<ul style="list-style-type: none"> <li>të zhvillojë modelet he mjete të standardizuara për: mbledhjen e të dhënave; monitorimin e aktiviteteve; raportimin; gjurmimin e pjesëmarrësve; konsolidimin rajonal të të dhënave;</li> <li>të përgatisë udhëzime praktike për përdoruesit për stafin e OEK.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Modele të standardizuara monitorimi;</li> <li>Modele raportimi;</li> <li>Mjete për mbledhjen e të dhënave;</li> <li>Udhëzime/manual për përdoruesit.</li> </ul>
<b>Detyra 3: Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi në OEK</b>		
Nëndetyra	<p>Konsulenti duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>organizojë dhe lehtësojë dy punëtori të brendshme me stafin e OEK-ut;</li> <li>mbështesë përcaktimin e roleve, përgjegjësi dhe rrjedhave të punës që lidhen me zbatimin e M&amp;V;</li> <li>krijojë mekanizma koordinimi të brendshme për proceset e M&amp;V.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dy punëtori të fasilituara;</li> <li>Matrica e përcaktuar e roleve dhe përgjegjësi të M&amp;V-së;</li> <li>Rekomandime për rrjedhën e punës së brendshme.</li> </ul>

<b>Detyra 4: Ngritja e kapaciteteve të stafit të OEK-ut</b>		
Nëndetyra	<p>Konsulenti duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>organizojë dhe lehtësojë dy punëtorë për ndërtimin e kapaciteteve të M&amp;V për stafin e OEK-ut;</li> <li>ofrojë trajnim praktik mbi: <ul style="list-style-type: none"> <li>o metodologjitë e monitorimit;</li> <li>o mbledhjen e të dhënave;</li> <li>o standardet e raportimit;</li> <li>o analizën e të dhënave;</li> <li>o përdorimin e mjeteve të monitorimit.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dy punëtorë trajnimit për M&amp;V të mbajtura;</li> <li>Materialet e trajnimit dhe prezantimet;</li> <li>Listat e pjesëmarrjes në punëtorë dhe formularët e vlerësimit.</li> </ul>
<b>Detyra 5: Analiza e të dhënave dhe raportimi</b>		
Nëndetyra	<p>Konsulenti duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të mbështesë përdorimin operacional të sistemit të sapokrijuar të M&amp;V;</li> <li>të konsolidojë dhe analizojë të dhënat e monitorimit nga të gjitha rajonet;</li> <li>të përgatisë një raport analitik të M&amp;V me gjetje dhe rekomandime.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti i analizës rajonale të të dhënave;</li> <li>Raporti analitik i M&amp;V;</li> <li>Rekomandime për përmirësimin e zbatimit të Arsimit Dual.</li> </ul>

#### 4. Kohëzgjatja e angazhimit

Detyra pritet të zbatohet për një periudhë prej afërsisht 3 muajsh nga data e nënshkrimit të kontratës.

#### 5. Ditët e punës së detyrës

Niveli i vlerësuar i angazhimit për këtë konsulencë është si vijon:

Aktiviteti	Numri i vlerësuar i ditëve të punës
Hartimi i kornizës së M&V	16 ditë pune
Zhvillimi i mjeteve të M&V	8 ditë pune
Analizimi dhe raportimi i të dhënave	8 ditë pune
Punëtoritë dhe ngritja e kapaciteteve	Përfshirë në shumën totale (lump sum)

## 6. Dorëzimet dhe afatet kohore

Aktiviteti	Java
<b>Takimi fillestar dhe plani i punës</b>	Java 1
Drafti i kornizës së M&V	Java 3
Mjetet e standardizuara të M&V	Java 5
Punëtori të brendshme të realizuara	Java 6
Punëtori për ngritjen e kapaciteteve të realizuara	Java 8
Korniza dhe mjetet finale të M&V	Java 10
Raporti përfundimtar analitik	Java 12

## 7. Kualifikimet e kërkuara për kompaninë/konsulentin

Konsulenti/kompania duhet të përmbushë kërkesat minimale të mëposhtme:

Për kompaninë/konsulentin:

- Minimum 5 vjet përvojë në Monitorim dhe Vlerësim;
- Përvojë e dëshmuar në projekte zhvillimi, mundësisht në arsim, Arsim dhe Aftësim Profesional, tregun e punës ose zhvillimin e sektorit privat;
- Përvojë në hartimin e sistemeve dhe mjeteve të raportimit M&E;
- Përvojë në fasilitimin e punëtorive dhe trajnimeve.

Ekspert(ët) kryesor(ë):

- Diplomë universitare në ekonomi, arsim, statistikë, shkencë sociale, administratë publike ose fusha të ngjashme;
- Njohuri të forta të metodologjive M&V dhe analizës së të dhënave;
- Aftësi të shkëlqyera në shkrimin e raporteve dhe fasilitim;
- Njohja e sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional (VET) në Kosovë konsiderohet përparësi.

## 8. Buxheti

Buxheti i përgjithshëm i vlerësuar për këtë detyrë është 11,000 EUR (PA TVSH), i ndarë si vijon:

Aktiviteti	Buxheti (EUR)
<b>Hartimi dhe ngritja e kornizës së M&amp;V</b>	4,000
Zhvillimi i mjeteve të standardizuara të M&V	2,000

Punëtoritë për rolet dhe përgjegjësitë	1,000
Punëtoritë për ngritjen e kapaciteteve	2,000
Analizimi dhe raportimi i të dhënave	2,000
<b>Total</b>	<b>11,000</b>

Buxheti përfshin tarifën e konsulentëve, fasilitetin e punëtorëve, materialet e trajnimit, transportin, logjistikën dhe të gjitha kostot e lidhura me zbatimin.

### 9. Raportimi dhe koordinimi

Menaxhimi i kësaj konsulence do të bëhet nga menaxheri i projektit të Arsimit Dual në OEK. Menaxheri i projekteve të Arsimit Dual brenda OEK-ut do të jetë personi kontaktues për këtë detyrë. Të gjitha dorëzimet duhet të dërgohen në gjuhën angleze dhe shqipe në format elektronik.

### 10. Procedura e Aplikimit

Kandidatët/kompanitë e interesuara ftohen të dorëzojnë:

- Propozim teknik;
- Propozim financiar;
- Profilin e kompanisë/CV-të e ekspertit/ekspertëve;
- Dëshmi të përvojës përkatëse;
- Referenca nga detyra të ngjashme.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

### 11. Kriteri i përzgjedhjes

1. Propozimi teknik 70% ( metodologjia e punës, kualifikimi, CV, përvoja dhe referenca
2. Propozimi financiar 30%

### 12. Konfidencialiteti dhe pronësia e të dhënave

Të gjitha të dhënat dhe informacionet e gjeneruara në kuadër të kësaj detyre duhet të jenë në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave, në veçanti me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave 2016/679, si dhe me ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave në Kosovë.

Të gjitha të dhënat dhe informacionet e pranuar nga konsulenti duhet të trajtohen si konfidenciale dhe të përdoren vetëm në lidhje me zbatimin e këtij angazhimi. Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale që rrjedhin nga zbatimi i detyrës i kalojnë OEK-ut. Informacioni që do të gjenerohet, si dhe përmbajtja e materialeve të shkruara të siguruar dhe të përdorura gjatë zbatimit të detyrës, nuk duhet t'i zbulohen asnjë pale të tretë dhe as të përdoren diku tjetër pa marrëveshje paraprake me Odën Ekonomike të Kosovës.

Lulzim Rafuna

Kryetar

Oda Ekonomike e Kosovës



